

2016

# Pakë histori për shahistët Shqipëtar nëpër olimpiada...



Avni Ermeni

NGA WEBFAQET E NDRYSHME

## Texte për OLIMPIADEN E SHAHUT NGA WEBFAQET

**Ka qenë një çast në historinë e Shqipërisë kur Enver Hoxha e ka përdorur jo si retorikë, por në kuptimin e plotë të fjalës fushën e shahut për të vënë në jetë politikën e tij kundrejt vendeve të tjera. Rasti për të cilin po flasim i përket vitit 1972, të cilin diktatori komunist e pa si një mundësi të përkryer për të shfaqur prirjet dhe tendencatpolitike**

Në sajë të ngarkesës së fortë psikologjike që shahistët ushtrojnë mbi njëri-tjetrin, dozës së lartë të dinakërisë e intelektit që kërkohet medoemos, mënyrës se si mjeshtrit e mëdhenj përpiqen të parashikojnë lëvizjet e kundërshtarit apo më mirë akoma për t'i zënë këta në kurth, loja e shahut shumë shpesh përqaset apo përdoret për të simbolizuar politikën. Në të njëjtën mënyrë si mjeshtrit e shahut krijojnë e përdorin strategji teksa kërkojnë të zbulojnë anët e dobëta të kundërshtarit për t'i përdorur më pas në dobi të tyre, edhe “mjeshtrit” e politikës përdorin strategjitë e pikat e dobëta të rivalëve për të dalë fitimtarë në arenën e ndeshjeve politike. Janë këto disa nga tiparet e përbashkëta, falë të cilave fusha e shahut njehsohet shumë natyrshëm me politikën, ndërsa lojtarët e shahut me politikanët. Por ka qenë një çast në historinë e Shqipërisë, kur Enver Hoxha e ka përdorur jo si retorikë, por në kuptimin e plotë të fjalës fushën e shahut për të vënë në jetë politikën e tij kundrejt vendeve të tjera. Rasti për të cilin po flasim i përket vitit 1972, kur në qytetin e Shkupit, kryeqytetin e Maqedonisë, një prej republikave që përbënin Jugosllavinë e atëhershme, zhvillohej Olimpiada Botërore e Shahut, të cilën diktatori komunist e pa si një mundësi të përkryer për të shfaqur prirjet dhe tendencat politike. Olimpiadat e Shahut, përveç të qenit pikëtakimi më i rëndësishëm për ndeshjet në skuadra të këtij kompeticioni mendor, si manifestime sportive, fshehin ndër vete edhe karakteristika të përsosura për të shfaqur prirjet gjeopolitike, jo më shumë se të vetë

pjesëmarrësve, sesa kombet apo formacionet politike që përfaqësojnë. Sidomos gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, për vendet e varfra të bllokut komunist, të cilat nuk mund t'i lejonin vetes stërvitjen e rritjen e sportistëve të disiplinave atletike, gjë që kërkon traditë, talente e shpenzime të konsiderueshme financiare, shahu përbënte edhe sportin e përsosur për t'u përfaqësuar me shpenzime minimale në kompeticione mjaft të rëndësishme e në evenimente ku merrnin pjesë gjithfarë kombesh e shtetesh. Kjo për një seri motivesh, ndër të cilët duhet veçuar bagazhi tepër i vogël logjistik për të cilin ka nevojë ky sport: mjafton një tavolinë shahu e një orë kronometruese. Për më tej, është një disiplinë ku nuk nevojiten ambiente stërvitjeje, trajnerë, specialistë e mjekë. Një karakteristikë tjetër që e bën kaq të volitshëm në një synim të tillë është edhe numri mjaft i kufizuar i shahistëve të skuadrave, që përbëheshin nga katër titullarë e dy rezerva. Në Olimpiadën e Shahut të vitit 1972, Shqipëria luajti në grupin eliminator numër 7 dhe për një seri rrethanash pak të favorshme ndaj saj nuk arriti të bëhej pjesë e finales A ku ndesheshin 16 kombëtares më të mira të botës vetëm për gjysmë pike. Në turin e fundit eliminator për të mos rrezikuar kualifikimin për në finale, vendet e ulëta dhe Porto Riko i çuan në remi të katërta ndeshjet në mënyrë që të nxirrnin artimetikisht jashtë loje Shqipërinë, e cila, edhe duke fituar 4-0 kundër Irakut, e pa veten jashtë finales A. Për gazetarin italian, Xhovani Armilota, i cili e solli në vëmendjen e publikut këtë fakt pak muaj më parë, kjo marrëveshje ishte mjaft e pistë, por, lidhur me kombëtaren tonë të shahut, merr një rëndësi të veçantë, pasi ky makinacion e detyroi skuadrën shqiptare të përballlej me Izraelin, një ndër shtetet me të cilin delegacioni ynë olimpik kishte deklaruar që në fillim se nuk pranonte të ndeshjej. Shqipëria nuk qe e vetnija që e ngrinte zërin kundër luftës së padrejtë të izraelitëve kundër vendeve arabe, një gjë të tillë e bënin me forcë edhe vendet e kontrolluara nga Bashkimi Sovjetik, por megjithëkëtë, në mënyrë oportuniste pranuan të ndesheshin me skuadrën e Izraelit, sidomos duke parë se në radhët e saj nuk

gjendeshin mjeshtër të mëdhenj, gjë që u ofronte mundësinë të fitonin mjaft pikë. Çekosllovakia, Mongolia dhe Polonia kishin pranuar të ndesheshin me skuadrën izraelite në vitet 1968 dhe 1970, madje edhe vetë Bashkimi Sovjetik kishte pranuar të ndeshej duke i marrë katër pikë në vitin '70. Ajo që nuk tërhiqej asnjë hap prapa, duke u dhënë përparësi absolute motivimeve politike në dëm të sportivitetit ishte pikërisht Shqipëria. Duhet thënë se për kombëtaren tonë të shahut, Olimpiada e Shkupit të vitit 1972, nuk përbënte rastin e parë ku u duhej të hiqnin dorë nga ndeshjet për shkak të “urdhrave nga lart”. Mjeshtri i Merituar i Shahut, Ylvi Pustina, i cili ka hequr dorë nga kompeticionet zyrtare shahistike vetëm pak kohë më parë, sjell ndërmend shumë raste të përafërta, ndër të cilat, nuk mund të lihet pa u përmendur ai i 8 tetorit të vitit 1970 në Olimpiadën XIX të Shahut të mbajtur në Zigen të Gjermanisë. Në atë kompeticion, skuadra shqiptare nuk pranoi të luante kundër Republikës së Afrikës së Jugut, në shenjë proteste ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut nga regjimi pretorian. Edhe këtu, Shqipëria do të ishte vendi i vetëm që nuk do të bënte asnjë lëshim, pasi, vetëm një ditë më pas, Bullgaria, edhe ajo një ndër vendet që ngrinte zërin kundër regjimit pretorian, pranoi pa asnjë problem të luante kundër skuadrës jugafrikane. 8 tetori i vitit 1972 ishte edhe dita kur kombëtarja shqiptare duhej të takohej me atë të Izraelit. “Situata ishte disi paradoksale”, sjell ndërmend mjeshtri Pustina, një ndër gjashtë shahistët që përbënin skuadrën tonë në Olimpiadën e Shkupit, “pavarësisht preferencave apo përkatësive politike, asnjë shtet tjetër nuk sillej në mënyrë kaq drastike. Madje, edhe vetë arabët, për të cilët skuadra jonë po flijojë në njëfarë mënyre, nuk kishin kurrfarë problemi të përballeshin me Izraelin”. Skuadra shqiptare thjesht nuk u paraqit atë ditë, me gjithë lutjet e organizatorëve, të cilët qenë të gatshëm të mbyllnin një sy, si në vitin 1970, në Zigen të Gjermanisë, kur megjithëse nuk u paraqit në ndeshjen me Afrikën e Jugut, nuk iu desh të përballej me asnjë masë ndëshkuese apo dënim nga ana e FIDE-s (Federatës Ndërkombëtare të Shahut). Madje, përsëri skuadrës sonë iu dha një

shans tjetër e iu propozua që ndeshjen me Izraelin ta shtynte për në fund të turneut, zgjidhje të cilën delegacioni ynë sportiv sërish nuk e pranoi. Sipas këndvështrimit të gazetarit italian, Xhovani Armilota, më pas do të ishin organizatorët jugosllavë që do ta përkeqësonin më tej gjendjen e kombëtares shqiptare, të cilët, këmbënguljen e kësaj të fundit, e vlerësuan si një mbështetje të hapur ndaj sulmit terrorist që atletët izraelitë kishin pësuar vetëm 1 muaj e tri ditë më parë në Olimpiadën e Munihut. Në këtë pikë, Federata Shqiptare e Shahut u tërhoq e indinjuar nga kompeticioni, duke ngritur zërin mbi mbështetjen ndaj popujve arabë. Për Armilotën, fakti më ironik në gjithë këtë lojë politike në fushën e shahut, ishte se ditën që Shqipëria zhvillonte ndeshjen e fundit, “revolucionarët e mëdhenj” të Fidel Kastros luajtën pa kurrfarë problemi kundër Izraelit. Revista “Italia shahistike” do të shkruante vetëm pak ditë më pas: “Mëkat i vërtetë, pasi skuadra shqiptare ishte vendosur shumë mirë në klasifikim dhe ishte treguar mjaft kompakte” (duhet thënë se ekipi shqiptar, mundi edhe Italinë përpara se të skualifikohej). Në atë periudhë, në gazetën jugosllave “Politika”, të gjithë patën mundësinë të lexonin artikullin me titull “Shqipëria mes të fuqishmëve të shahut”.

Një mëkat i vërtetë edhe për mjeshtrin Pustina, pasi “skuadra ishte me të vërtetë mjaft cilësore dhe mund të kishte bërë shumë përpara në atë kompeticion”. Teksa përpiqet të sjellë ndërmend në mënyrë të detajuar atë ngjarje, shahisti i njohur nuk mund të lërë pa përmendur frymën sportive që ekzistonte mes gjithë shahistëve, madje jo vetëm këtë, por edhe përpjekjet maksimale të organizatorëve e drejtuesve të Olimpiadës për të anashkaluar përfshirjen e politikës në përfaqësimin e kombëtares sonë. Madje, pasi delegacioni shqiptar deklaroi paraprakisht vendet kundër të cilave nuk pranonte të ndeshej, organizatorët bënë të pamundurën për ta vendosur ekipin tonë në grupe ku të mos gjendej asnjë nga këto “skuadra të padëshirueshme”. Por me kalimin e tureve dhe pas eliminimeve, numri i skuadrave zvogëlohej dhe në një çast të caktuar përballja me një të tillë ishte e pashmangshme, siç ndodhi edhe me

Izraelin. Në të kundërt të asaj që është thënë zyrtarisht, mjeshtri Pustina, ka bindjen se ajo që komprometoi përfundimisht fatin e skuadrës shqiptare, do të ishte refuzimi që i bëri delegacioni shqiptar ftesës së Titos për të takuar dy përfaqësues nga të gjitha skuadrat që merrnin pjesë në kompeticion. Ftesë që padyshim nuk mund të pranohej nga asnjë nga shahistët shqiptarë, për shkak të marrëdhënieve të vendit tonë me Jugosllavinë. Pustina shton se drejtuesi, numri një i olimpiadës, Jordan Ivanovski, i kontaktoi personalisht për t'u nënvizuar se mospranimi i kësaj vizite kortezie do të komprometonte në mënyrë të pariparueshme ecurinë e skuadrës në Olimpiadë, duke shtuar se askush prej pjesëtarëve të skuadrës as që guxoi të kërkonte leje për një gjë të tillë. "Orientimet dhe direktivat ishin më se të qarta", shprehet ish-profesori i universitetit Pustina, "ishin të përcaktuara paraprakisht të gjitha skuadrat kundër të cilave mund të ndesheshim dhe të tjerat me të cilat nuk do të kishim asnjë lloj kontakti". Se sa e rëndë ishte ajo ngjarje për fatin e shahistëve shqiptarë, mjafton të sillet ndërmend se duhej pritur plot tetë vjet që mjeshtrit tanë të merrnin pjesë në një kompeticion ndërkombëtar të këtyre përmasave. Kjo, pasi Federatës sonë të Shahut iu kërkua që përpara çdo kompeticioni të lëshonte një deklaratë zyrtare në të cilën të zotohej se nuk do të tërhiqej nga asnjë ndeshje për motive politike, kusht që nuk mund të pranohej nga vendi ynë. Për Pustinën ishte ngjarje fatale, pasi privoi mjeshtrit shqiptarë nga përballjet me të mëdhenjtë e botës së shahut, ku deri atë çast kishin arritur të shfaqeshin në mënyrë mjaft të suksesshme. Madje, duke parë rezultatet e deriatëhershme, gjatë Olimpiadës së Shkupit, mund të ishin renditur fare lehtë mes më të mirëve, duke lënë pas vende të mëdha e me mjaft traditë. Por megjithatë, mjeshtri shton se politika e Hoxhës vërtet i privoi nga kënaqësia e një pozicionimi dinjitoz në renditjen e skuadrave të olimpiadës, por kurrsesi nuk ia doli të shkulte frymën sportive dhe njerëzore që burojnë nga kompeticione të tilla: "Menjëherë pas rënies së komunizmit, më 14 nëntor të vitit 1991, nga Shkupi mbërrin një pako. Ishte dërguar nga Slobodan Mihajlovski, një prej

gjqtarëve të Olimpiadës së vitit 1972. Brenda ishte libri me titull ‘Olimpiada e Shkupit, viti 1972’. Në faqen e parë të tij, për habinë time të madhe, gjyqtari kishte shkruar në gjuhën shqipe ‘Për Mjeshtrin e Merituar, Ylvi Pustina’”.

Lorenc Rabeta

### **Magjia e katrorve bardheë e zi**

Kur u prezantua mes shqiptarëve loja e vjetër persiane. Fillesat, ata që shkëlqyen dhe edicioni fantastik i vitit 1972, kur vetëm politika bëri që shahistët tanë të mos shkonin zyrtarisht drejt niveleve të ajkës botërore



Në një shtëpi të vjetër në Tiranë, pikërisht në një odë të madhe e tepër të thjeshtë në skaj të oborrit, fusha e drunjte e shahut nuk mbyllej kurrë, ndërsa dy ushtritë, e bardha dhe e zeza qendronin përballë njëra-tjetrës në çdo orë të ditës e të natës. Tabloja ndryshonte vetëm kur dy njerëz, në 100 për qind të rasteve burra, uleshin përkundrajt dhe nisnin një lojë që mund të zgjaste tepër shumë. Këtë e mbaj mend mirë nga shtëpia e vjetër e familjes sime në rrugën Bardhyl, apo me emrin gjithashtu fisnik të asaj kohe “Gogo Nushi”. Në vitet 80-të aty luhej jashtë mase, por jo vetëm aty.

Në një zonë më qendrore të kryeqytetit, në bulevardin e sotëm “Zog I”, një vatër shahu ishte pranë ATSH-së së dikurshme, pranë selisë së gazetës “Zëri i Popullit” dhe nuk është një rastësi që shumë nga shahistët më të mirë të Shqipërisë lindën pikërisht aty. Seitaj, Zadrime apo Adhami sa për të përmendur disa emra.

Gjithsesi, loja në vend ka ardhur hershëm, që në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, ndërsa mbahet mend me emër një elbasanas, Abdullahu me mbiemrin e veçantë Tirana dhe që u shfaq në vitin 1910. Ky Abdullah paska qenë haxhi në Mekë dhe atje paska mësuar lojën e vjetër persiane, duke marrë me vete edhe kutinë me gurët dyngjyrësh.

Ndërsa bota prodhoi gjigandë, Shqipëria e vogël vuajti jo pak për ta zhvilluar këtë lojë magjike. Që nga kampionati i parë organizuar më 1933 deri tek i dyti duhej të kalonin 14 vjet, ndonëse federata u krijua pikërisht vitin kur u shpall kampioni i parë, Xhaferr Çaushaj nga Elbasani.

Gjithsesi, nuk ishim ende kërrkund në hartë, edhe pse gjithçka zhvillohej me rregull dhe arena shqiptare dominohej nga dy mjeshtra të shkëlqyer si Ylvi Pustina dhe Esat Duraku.

Pikërisht i pari, Pustina i madh, ishte kapiteni i një ekipi kombëtar që më 1960 shkeli në një tokë të panjohur për shahun shqiptar, në një Amerikë tjetër. Bëhet fjalë për Olimpiadën Botërore të shahut. Atë vit (1960), në mes të 40 ekipe, në ish-RDGJ (Republika Demokratike Gjermane), Shqipëria doli e parafundit në grupin 1, pas Bullgarisë, Jugosllavisë, RDGJ-së, Norvegjisë, Finlandës, Izraelit, Indonezisë dhe Francës, duke lënë pas Maltën. Shqiptarët fituan 10.5 pikë, vetëm gjysmë pike më pak se Franca, ndërsa Malta pati vetëm 3 pikë. Pustina, Hoxha, Konçi dhe Veizaj ishin pjesëmarrësit tanë, që arritën një fitore të shkëlqyer ndaj Francës 3-1 (Pustina e Veizaj triumfuan, Hoxha e Konçi dolën barazim). Shqipërisë i kushtuan dy barazimet ndaj Maltës (Pustina e Hoxha), në një fitore 3-1. Veçse, ata që janë marrë dhe që e duan shahun, veçojnë një tjetër datë historike, mjaft vite pas debutimit, por tepër larg kohës që ne jetojmë sot.

Ishte viti 1972, Shqipëria nuk ishte as tepër e hapur, por as tërësisht e mbyllur dhe në Tiranë e qytete të tjerë si Shkodër apo Korçë, kishin ende vend minifundet, dekoltetë, këpucët e modës, flokët jo edhe aq të shkurtër si dhe muzika që vinte nga Italia, por



që ishte e gjithë botës. Bar-lulishtet ishin plot, dritat shkëlqenin dhe birra “Tirana” e “Korça” si dhe uji i shkëlqyer mineral “Glina” nuk ua kishin edhe aq zili pijeve perëndimore.

Klima ishte pak më e nxehtë se e tanishmja, pasi ekipi shqiptar mori pjesë në Olimpiadën e 20-të botërore të shahut nga 18 shtatori deri në 13 tetorin e 1972-it.

Rruga për të shkuar nuk ishte aspak e gjatë, pasi Olimpiada u mbajt në qytetin gjysmë shqiptar të Shkupit. Ekipi i përbërë nga Ylvi Pustina, Florian Vila, Vangjel Adhami, Fatos Muço, Fatos Omari dhe Aldo Zadrime (katër tavolinat plus dy rezervat) habitetj ndërsa kalonte pranë sahatit të qytetit, akrepët e të cilit ishin ndalur në momentin e rënies së tërmetit të rëndë më 1963 dhe që autoritetet jugosllave e kishin lënë ashtu të paprekur, bashkë me ndërtesën e shkatërruar të stacionit hekurudhor, në mënyrë që banorët të mos harronin.

Shkupi ishte ndërtuar nga e para që nga ai vit që ishte ende tepër i afërt dhe shkëlqente me ndërtesat e reja, me parqet dhe sistemimin e plotë të brigjeve të lumit të Vardarit, plot me rrugë, trotuare, pemë dhe hapësirë që ishte lënë pa u kursyer. Fshati olimpiq ishte i thjeshtë e i bukur si dhe krejt i jashtëzakonshëm për ata personalitete që ishin mbledhur aty. Në ballë ishte “zbornaja komanda”, Bashkimi i madh Sovjetik, 9 herë radhazi kampion i botës.

Ashtu si në Lojrat Olimpikë Verore, sovjetikët ishin bërë dominues sapo kishin vendosur të merrnin pjesë. Ekipin shndriste nga emrat të ndjerit Tigran Petrosjan (kampion bote më 1963-1969), Viktor Korçnoit (nënkampion i botës), Vasili Smisllavit (kampion i botës 1957-1958), Mihail Tal (kampion i botës 1960-1961), yllit të madh që lindi pikërisht në atë olimpiadë Anatoli Karpov (kampion i botës 1975-1985 dhe 1993-1999) dhe kampionit në fuqi të Bashkimit Sovjetik, Vladimir Savon.

Aty ishin hungarezët e mëdhenj, jugosllavët, amerikanët, gjermanët, bullgarët, rumunët, çekoslovakët, të gjithë të mbushur me mjeshtria të mëdhenj, ndërsa Shqipëria e vogël dhe krejt e panjohur nuk kishte as edhe një mjeshtër ndërkombëtar. Këtë nivel do ta arrinte shumë vjet më vonë Fatos Muço, ndërsa Erald Dervishi u bë më në fund, në vitet 90-të Mjeshtër i Madh dhe mbetet i tillë.

Nisja e shqiptarëve ishte e vetëtishme me një fitore 3.5-1.5 ndaj Porto Rikos. Askush nuk priste që fqinjët e Jugosllavisë të luanin ndonjë rol, por shpejt dolën të gabuar. Ndeshja e dytë ishte ndaj Andorrës, të cilën tanët e mundën 3-1, duke kapur kreun e renditjes me 6.5 pikë po aq sa Holanda e Bullgaria. Fitore edhe në ndeshjen e tretë, atë ndaj Kolumbisë (2.5-1.5) dhe sërish vendi i parë në grupin 7, ndërsa pas saj erdhi humbja 1-3 me Bullgarinë e fuqishme ku Pustina dhe Adhami mundën të merrnin nga një barazim.

Menjëherë më pas nisi ndjekja e vendit të parë ose të dytë me një tjetër fitore të shkëlqyer, 3.5-0.5 ndaj Australisë ku gjysmëpika e vetme u humb në tavolinën e parë, më të fortën, ku Pustina barazoi me Braunin (në foto) që kishte koeficient shumë më të lartë sesa ai (2530 ndaj 2250). Vlen të theksohet se krejt ekipi australian kishte mesatare Eloje më të lartë sesa ai shqiptar. Vetëm Andorra dhe Iraku kishin Elo më të vogël se ne.

Në raundin e parafundit ndaj Holandës duhej fitore e thellë për të kapur vendin e dytë, por kjo nuk ndodhi. Madje, shqiptarët as nuk deshën. Aldo Zadrina, një nga protagonistët e Olimpiadës rrëfen sesi me shumë dëshpërim ekipi vendosi vullnetarisht të mos luftonte për të hyrë mes 16 më të mirëve të botës. Arsyeja ishte tepër e thjeshtë për atë kohë. Në finalen A do të ishin edhe Bashkimi Sovjetik, edhe SHBA, dy vende me të cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie dhe ndaj ekipeve të së cilëve nuk do të mund të luante.

U zgjodh që të pranohej niveli pak më i ulët, finalja B, me renditje nga vendi i 17-të deri në të 32-in në botë. Aty do të ishte Izraeli, me të cilin gjithashtu nuk mund të luhej, por të paktën bëhej fjalë për një pengesë, jo për dy. Shqipëria doli barazim 2-2 me Holandën me Elo 2465, madje barazim dolën të katër ndeshjet, diçka vërtet interesante. Ky rezultat bëri që fitorja 4-0 në ditën e fundit ndaj Irakut të mos kishte vlerë për vendin e parë, edhe pse Bullgaria e Holanda vetëm barazuan. Në përfundim të ndeshjeve në grup, Shqipëria grumbulloi 19.5 pikë, vetëm gjysmë pike më pak sesa Holanda dhe vetëm 1 pikë më pak sesa Bullgaria që doli e para.

Në grupin final B, sërish starti shqiptar ishte befasues me një fitore 3-1 ndaj Belgjikës, duke qenë e para në grup bashkë me Anglinë. Më tej, një barazim 2-2 me Mongolinë dhe zbritje vetëm gjysmë pike poshtë vendit të parë. Ndaj Kubës u pësua një humbje 1.5-2.5 duke mbetur edhe më prapa kreut, por ndaj Kanadasë u arrit fitore identike (2.5-1.5) me Vilën e Muçon që triumfuan dhe Adhamin që barazoi. Pasi një humbje e thellë 0.5-3.5 ndaj Islandës (Pustina mori barazimin e vetëm) dhe fitorja e shkëlqyer 3-1 ndaj Norvegjisë. Ndaj Anglisë për pak nuk u mor barazimi (1.5-2.5), por kjo ishte përpjekja e fundit para katastrofës Më 4 tetor, skuadra izraelite u ul në tryezat e caktuara për të luajtur ndeshjet e raundit të 8-të ndaj kundërshtarit të fortë shqiptar.

Pritja ishte e kotë pasi shqiptarët nuk u dukën. Urdhëri nga Tirana ishte i prerë: Ndaj Izraelit, atij që quhej xhelati i popujve arabë, nuk mund të luhej. Pak rëndësi kishin pasojat (kujtoj një histori të basketbollit kur ekipi shqiptar nuk luajti ndaj Izraelit, ndërsa Egjipti që sapo kishte bërë luftë me të, vendosi të luante!!). Gjithsesi, organizatorët e Olimpiadës nuk vendosën ta përjashtonin Shqipërinë dhe ajo arriti një tjetër fitore të shkëlqyer, këtë herë ndaj Italisë 2.5-1.5 ku Pustina mundi mjeshterin ndërkombëtar Tatai, Muço mundi po mjeshterin ndërkombëtar Paoli dhe Zadrina barazoi me Kapelon.

Më tej u luajt pa impenjim, me mendjen si shpesh herë tek blerjet nëpër Shkup, ndërsa shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë ishin aq të lumtur që kishin mes tyre shahistët e Shqipërisë. Përfaqësuesja humbi 1-3 me Austrinë (ndaj së cilës u hakmorr në kampionatin europian duke fituar po 3-1) dhe së fundmi u mund 1.5-2.5 ndaj Kolumbisë. E zbritur në vendin e 28-të, Shqipëria u tërhoq përfundimisht pas 8 tetorit, ndërsa ndodhi edhe një ngjarje që vulosi përfundimisht përjashtimin tonë. U refuzua takimi me të zotin e shtëpisë, presidentin e Jugosllavisë, Josip Broz Tito. Të 62 ekipet e tjerë shkuan dhe takuan udhëheqësin jugosllav, ndaj të cilit në Shqipëri kishte alergji (krejtësisht të justifikueshme) vetë Enver Hoxha. Ndërsa kampionët e mëdhenj Petrosjan, Smisllov dhe Botvinik (i ftuar special në Olimpiadë) takoheshin e bisedonin me Titon, shqiptarët bënë gati valixhet për t'u kthyer në atdhe.

Merrte fund kështu, në një mënyrë krejt të pamërituar dhe të padenjë, një përfaqësim i jashtëzakonshëm i një skuadre që habiti krejt botën, i një Shqipërie që askush nuk e njihnte dhe nuk e vlerësonte, por që i çmeriti me nivelin e saj shumë më të lartë sesa thoshte Eloja e kondicionuar nga izolimi. Zadrimea e kujton shumë mirë sesi jugosllavët nuk linin superlativa pa dhënë për ekipin shqiptar.

“Ku paskeni qenë ju, thoshin ata, Ne kemi bërë stërvitje në Ohër (shqiptarët u përgjigjeshin se ishin stërvitur në Pogradec). Po përse stërviteshim vetëm? Më mirë të kishim bërë ndeshje stërvitore me ju”. Shahisti shqiptar ruan si relike miqësinë me njërin nga më të mëdhenjtë mjeshtra të Jugosllavisë. Ljubomir Ljubojeviç është ende gjallë dhe dy miqtë takohen, por 1972-shi ishte kohë tjetër dhe i duhej përvjedhur vëzhgimit të shoqëruesve për të biseduar.

Zadrimea e Ljubojeviç (medalje e artë në tavolinën e tretë në 1972) bisedonin në rusisht për mënyrat e lojës së shahut. Tepër miqësor serbi që në karrierë mundi edhe kampionët e botës Anatoli Karpov e Gari Kasparov. Aty shqiptarët do të njihnin edhe më të

madhin shahist të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë. Zvetozar Gligoriçi, ish-partizani i luftës së dytë botërore, u ngjante shumë shqiptarëve. Ashtu si shumë shqiptarë, ai u lind në një familje të varfër dhe mësoi shahun vjedhurazi duke ndjekur ndeshjet e “padronëve” ku punonte si shërbëtor. Po ashtu si shumë shqiptarë të varfër e të këputur, ai nuk kishte një kuti shahu, por e krijoi me dërrasa e kompensata, ndërsa gurët e tij ishin tapat e shisheve të verës. Kjo ngjan me historinë e mjeshtrit të madh sovjetik, letonezit Paul Keres. i madhi Gligoriç, që ka vetëm pak javë që ka vdekur, tregonte thelbin e shpirtit të tij kur titullonte autobiografinë “Unë luaj kundër gurëve”. Pra, jo kundër njerëzve.

Vdekja e Gligoriçit u pasua pikërisht këto ditë nga një humbje e madhe për shahun shqiptar, pasi ndërroi jetë një nga më të mirët përfaqësues të tij, Ilir Karkanaqe, dy herë kampion kombëtar me Dinamon. Shqipëria u rikthye në Olimpiada vetëm më 1980, kur federata e shahut zgjidhi problemin politik duke ndryshuar sistemin e garës, por viti 1972 nuk mund të harrohet.

Ishte po më 1972 kur Dinamo arriti në finalen e Kupës së Kampionëve të volejbollit të meshkujve, duke dalë në vendin e katërt në Europë, pak më vonë lindi edhe Dinamo e volejbollit të femrave, ndërsa Partizani i Tiranës ishte në gjendje përgjatë atyre viteve të hynte ndër 12 ekipet më të mira të Kupës së Kampionëve në basketboll për meshkuj.

Ah, të mos harrohet i madhi Ymer Pampuri i cili pikërisht në 1972 doli kampion i botës dhe vendosi rekordin olimpik në stilin e forcës në peshëngritje. Sot, kur nuk ka më salla dhe kur do të humbasë edhe e vetmja sallë publike në stadiumin kombëtar “Qemal Stafa”, veteranëve të shahut nuk u ka mbetur gjë tjetër veçse të kujtojnë historitë e vjetra dhe të japin edhe atë kontribut që u lejojnë forcat për vendin e tyre që prej 20 vjetësh nuk po arrin t’i vlerësojë.

Revista Klan nga Bledar Kuka

Janë shënime të huazuara nëpër webfaqe të ndryshme për ekipen olimpike Shqipëtare nëpër olimpiada të ndryshme.

Kamë menduar për të gjithë ata që dëshirojnë të lexojnë për shahun Shqipëtar ndoshta është me interes të dinë se qka ka ndodhur nëpër periudha të ndryshme dhe ndikimet politike kur ka të bënte për lojën e shahut.

Avni ERMENI